



## PRIORITETET E BANORËVE TË KOMUNËS SË KAMENICËS

Prishtinë, qershor 2015



# PRIORITETET E BANORËVE TË KOMUNËS SË KAMENICËS

*Ky publikim është pjesë e projektit Qytetarë aktiv komuna të përgjegjshme dhe transparente, që implementohet nga Advocacy Training and Resource Center-ATRC dhe financohet nga Olof Palme International Center, me mbështetje të Qeverisë Suedeze. Përmbajtja e këtij publikimi reflekton pikëpamjet e autorit dhe jo domosdoshmërisht të Olof Palme International Center.*

Prishtinë, qershor 2015

## Përmbajtja

|                                                                           |    |
|---------------------------------------------------------------------------|----|
| RRETH ATRC .....                                                          | 7  |
| RRETH PROJEKTIT .....                                                     | 8  |
| 1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR KOMUNËN E KAMENICËS .....                | 9  |
| 1.1 Popullsia .....                                                       | 9  |
| 1.2 Arsimi dhe Kultura .....                                              | 9  |
| 1.3 Historiku .....                                                       | 9  |
| 1.4 Mekanizmat e pjesëmarrjes qytetare në nivel lokal .....               | 10 |
| 2. PRIORITETET E BANORËVE .....                                           | 10 |
| 2.1 REKOMANDIMET E PËRGJITHSHME TË BANORËVE TË KOMUNËS SË KAMENICËS ..... | 10 |
| 2.2 REKOMANDIMET E GRUPIT TË GRAVE TË KOMUNËS SË KAMENICËS .....          | 11 |
| 2.3 REKOMANDIMET E PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA .....                   | 11 |
| 2.4 REKOMANDIMET E TË RINJVE .....                                        | 11 |
| 2.5 REKOMANDIMET E PËRFAQËSUESVE TË KËSHILLAVE LOKALE .....               | 12 |
| 3. KAMENICË - QENDRA .....                                                | 12 |
| 3.1 Pasqyra e përgjithshme .....                                          | 12 |
| 3.2 Rekomandimet e banorëve: .....                                        | 12 |
| 4. KAMENICË – LAGJA ILIRIA .....                                          | 13 |
| 4.1 Pasqyra e përgjithshme .....                                          | 13 |
| 4.2 Rekomandimet e banorëve: .....                                        | 14 |
| 5. KAMENICË – LAGJA QAMËRIA .....                                         | 14 |
| 5.1 Pasqyra e përgjithshme .....                                          | 14 |
| 5.2 Rekomandimet e banorëve: .....                                        | 15 |
| 6. KAMENICË – LAGJA MALËSIA .....                                         | 15 |
| 6.1 Pasqyra e përgjithshme .....                                          | 15 |
| 6.2 Rekomandimet e banorëve .....                                         | 16 |

|                                                |    |
|------------------------------------------------|----|
| 7. KËSHILLI I FSHATRAVE STREZOC.....           | 16 |
| 7.1 Pasqyra e përgjithshme.....                | 16 |
| 7.2 Rekomandimet e banorëve:.....              | 17 |
| 8. KËSHILLI LOKAL MUÇIVËRC .....               | 18 |
| 8.1 Pasqyra e përgjithshme.....                | 18 |
| 8.2 Rekomandimet e banorëve:.....              | 19 |
| 9. KËSHILLI I FSHATIT DAJKOC .....             | 19 |
| 9.1 Pasqyra e përgjithshme.....                | 19 |
| 9.2 Rekomandimet e banorëve:.....              | 19 |
| 10. KËSHILLI I FSHATIT RUBOC .....             | 20 |
| 10.1 Pasqyra e përgjithshme.....               | 20 |
| 10.2 Rekomandimet e banorëve:.....             | 20 |
| 11. KËSHILLI I FSHATIT KARAÇEVË E EPËRME ..... | 21 |
| 11.1 Pasqyra e përgjithshme.....               | 21 |
| 11.2 Rekomandimet e banorëve:.....             | 22 |
| 12. KËSHILLI I FSHATIT KARAÇEVË E POSHTME..... | 22 |
| 12.1 Pasqyra e përgjithshme.....               | 22 |
| 12.2 Rekomandimet e banorëve.....              | 22 |
| 13. KËSHILLI I FSHATRAVE AJNOVC.....           | 23 |
| 13.1 Pasqyra e përgjithshme.....               | 23 |
| 13.2 Rekomandimet e banorëve:.....             | 23 |
| 14. KËSHILLI I FSHATIT ROGANË.....             | 24 |
| 14.1 Pasqyra e përgjithshme.....               | 24 |
| 14.2 Rekomandimet e banorëve:.....             | 25 |
| 15. KËSHILLI I FSHATRAVE BOSÇË .....           | 25 |

|                                                                     |    |
|---------------------------------------------------------------------|----|
| 15.1 Pasqyra e përgjithshme.....                                    | 25 |
| 15.2 Rekomandimet e banorëve:.....                                  | 26 |
| 16. KËSHILLI I FSHATIT BUSAVATË .....                               | 26 |
| 16.1 Pasqyra e përgjithshme.....                                    | 26 |
| 16.2 Rekomandimet e banorëve:.....                                  | 26 |
| 17. KËSHILLI I FSHATRAVE HOGOSHT .....                              | 27 |
| 17.1 Pasqyra e përgjithshme.....                                    | 27 |
| 17.2 Rekomandimet e banorëve:.....                                  | 28 |
| 18. KËSHILLI I FSHATRAVE BERIVOJCË .....                            | 28 |
| 18.1 Pasqyra e përgjithshme.....                                    | 28 |
| 18.2 Rekomandimet e banorëve:.....                                  | 29 |
| 19. KËSHILLI I FSHATRAVE SHIPASHNICË E EPËRME .....                 | 29 |
| 19.1 Pasqyra e përgjithshme.....                                    | 29 |
| 19.2 Rekomandimet e banorëve:.....                                  | 30 |
| 20. KËSHILLI I FSHATRAVE SHIPASHNICË E POSHTME .....                | 31 |
| 20.1 Pasqyra e përgjithshme.....                                    | 31 |
| 20.2 Rekomandimet e banorëve të fshatit Shipashnicë e poshtme:..... | 32 |
| 20.3 Rekomandimet e banorëve të fshatit Kranidell:.....             | 32 |
| 21. KËSHILLI I FSHATIT HODONOC .....                                | 32 |
| 21.1 Pasqyra e përgjithshme.....                                    | 32 |
| 21.2 Rekomandimet e banorëve:.....                                  | 33 |
| 22. KËSHILLI I FSHATRAVE POLIÇKË .....                              | 33 |
| 22.1 Pasqyra e përgjithshme.....                                    | 33 |
| 22.2 Rekomandimet e banorëve:.....                                  | 34 |
| 23. KËSHILLI I FSHATRAVE DESIVOJCË.....                             | 34 |

|                                          |    |
|------------------------------------------|----|
| 23.1 Pasqyra e përgjithshme.....         | 34 |
| 23.2 Rekomandimet e banorëve:.....       | 35 |
| 24. KËSHILLI I FSHATIT KORETIN .....     | 35 |
| 24.1 Pasqyra e përgjithshme.....         | 35 |
| 24.2 Rekomandimet e banorëve:.....       | 35 |
| 25. KËSHILLI I FSHATRAVE TOPANICË .....  | 36 |
| 25.1 Pasqyra e përgjithshme.....         | 36 |
| 25.2 Rekomandimet e banorëve:.....       | 37 |
| 26. KËSHILLI I FSHATRAVE TUGJEC.....     | 37 |
| 26.1 Pasqyra e përgjithshme.....         | 37 |
| 26.2 Rekomandimet e banorëve:.....       | 38 |
| 27. KËSHILLI I FSHATIT PETROC .....      | 38 |
| 27.1 Pasqyra e përgjithshme.....         | 38 |
| 27.2 Rekomandimet e banorëve:.....       | 39 |
| 28. KËSHILLI I FSHATRAVE KOPERNICË ..... | 39 |
| 28.1 Pasqyra e përgjithshme.....         | 39 |
| 28.2 Rekomandimet e banorëve:.....       | 40 |
| 29. KËSHILLI I FSHATRAVE LISOCKË.....    | 40 |
| 29.1 Pasqyra e përgjithshme.....         | 40 |
| 29.2 Rekomandimet e banorëve.....        | 40 |

## RRETH ATRC

Advocacy Training and Resource Center - ATRC është organizatë Kosovare jo-fitimprurëse, e cila angazhohet për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe shoqërisë civile në vendimmarrje, si parakusht për një shoqëri të zhvilluar demokratike.

ATRC ndihmon në forcimin e rolit të OJQ-ve si agjent të ndryshimit në shoqëri, ngritë kapacitetin e OJQ-ve dhe iniciativave qytetare që të ndërmarrin kampanja avokimi dhe kontribuon në krijimin e institucioneve qeverisëse që i takojnë standardeve ndërkombëtare.

ATRC punon me përfaqësues të OJQ-ve, iniciativave qytetare, administratës publike, institucioneve politike, mediave, etj, pavarësisht nga bindjet dhe përkatësitë politike, fetare, etnike, etj.

Që nga themelimi i saj në vitin 2001, ATRC ka ndihmuar numër të madh të OJQ-ve në Kosovë duke synuar ngritjen e kapaciteteve dhe profesionalizimin në punën e tyre, krijimin dhe artikullimin e kërkesave të tyre dhe pajisjen me aftësi avokuese në strukturat e qeverisë në lidhje me çështjet që preokupojnë shoqërinë kosovare.

ATRC realizon qëllimet e veta përmes katër programeve kryesore të saj:

1. Programi i ngritjes së kapaciteteve, i cili synon që përmes trajnimeve dhe ofrimit të konsulencave, të rrisë kapacitetet e organizatave joqeveritare në Kosovë në fushën e zhvillimit organizativ, menaxhimit të projekteve dhe në avokim.
2. Programi i administrimit të Granteve, i cili synon të ndihmojë organizatat joqeveritare lokale, përmes granteve kryesisht në avokim.
3. Programi për Avokim, përmes projekteve të ndryshme ATRC synon të avokoj në institucione nacionale dhe lokale për probleme të ndryshme të cilat janë preokupim dhe brengë e qytetarëve në përgjithësi.
4. Informimi, me të cilin ATRC synon të ofroj informacione në mënyrë elektronike, përmes informacioneve të freskëta në ueb faqe, diskutime publike dhe tryeza të rrumbullakëta, ndërtim koalicioni, ndërmjetësim partneriteti dhe bashkëpunimi. ATRC, gjithashtu ofron librari me botime për çështjet sociale, politike dhe ekonomike që lidhen me Kosovën dhe rajonin.

## RRETH PROJEKTIT

Advocacy Training and Resource Center – ATRC me mbështetje financiare nga The Olof Palme International Center nga janari i vitit 2012 ka filluar së implementuari projektin “Qytetarë aktiv-komuna të përgjegjshme dhe transparente”. Projekti ka për qëllim rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse në nivel lokal, në komunën e Gjilanit, Vitisë, Kamenicës dhe Novobërdës.

Pas nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit në mes ATRC dhe Komunave të lartpërmendura ATRC ka zhvilluar një sërë aktiviteteve të përqendruara në ngritjen e kapaciteteve avokuese të qytetarëve në inicimin e praktikave të qëndrueshme dhe efektive në mes qytetarëve dhe komunave të tyre. Gjatë vitit 2014 ATRC ka inicuar themelimin e Komiteteve konsultative për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje në katër komunat e lartpërmendura.

Publikimi “Prioritetet e banorëve të Komunës së Kamenicës” është rezultat i takimeve që ATRC, në bashkëpunim të ngushtë me Komunën dhe anëtarët e Komitetit konsultativ për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje ka zhvilluar me përfaqësuesit e Këshillave Lokale si dhe qytetarë.

Përmes aktiviteteve që realizohen në kuadër të këtij projekti ATRC synon që të rris bashkëpunimin në mes Komunave dhe qytetarëve; t’u ofroj mundësinë qytetarëve që të shprehin lirshëm kërkesat dhe rekomandimet e tyre dhe të ushtrojnë presionin demokratik në institucionet lokale për marrjen në konsideratë të kërkesave të tyre gjatë hartimit të planeve komunale dhe njëkohësisht t’i ndihmoj Komunës në procesin e hartimit të buxhetit komunal, duke i ofruar të dhëna konkrete për secilin fshat veç e veç.

ATRC gjatë këtij viti do të vazhdoj me organizimin e aktiviteteve të përbashkëta në mes zyrtarëve komunal dhe qytetarëve, në mënyrë që rekomandimet e qytetarëve të paraqitura në këtë dokument të merren parasysh.



# 1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR KOMUNËN E KAMENICËS

Kamenica është komunë, e cila gjendet pjesën më lindore të Kosovës. Komuna e Kamenicës kufizohet me komunën e Ranillugut, Gjilanit, Prishtinës, Novobërdës si dhe komunat e RS të Serbisë: Bujanoc, Medvegjë dhe Vrajë. Kamenica gjendet 10 km. larg magjistrales Bujanoc - Gjilan, me të cilën lidhet me qendrat tjera të Kosovës.

Territori i Komunës së Kamenicës është kodrinoro-malor (70%) dhe rrafshinor (30%), me disa lugina rreth lumenjëve Krivarekë, Desivojcë dhe Hogosht, që shtrihen në veri. Toka është kryesisht pjellore, e pasur edhe me kullosa, e përshtatshme për zhvillim të pemëtarisë, perimtarisë, lavërtarisë dhe blegtorisë.

## 1.1 Popullsia

Komuna e Kamenicës ka 417km/2 dhe sipas regjistrimit të fundit të popullsisë në vitin 2011 36.085 banorë.

## 1.2 Arsimi dhe Kultura

Komuna e Kamenicës ka shtatë biblioteka publike me rreth 56.769 libra. Biblioteka kryesore ka 6.275 libra, ndërsa degët në Srezovc, Tygjec, Hogosht, Desivojcë, Karaçevë dhe Roganë kanë 56.769 libra. Vlen të theksohet se, në këtë komunë pasojat e masave të dhunshme (1990-1999) dhe luftës serbe kanë qenë më të vogla dhe Kamenica është e vetmja komunë në Kosovë ku ka mbetur numri i njëjtë i bibliotekave në koleksione.

Në Kamenicë janë 23 shkolla, nga të cilat 17 janë shkolla fillore dhe dy shkolla të mesme. Poashtu, janë dy shkolla të larta dhe tri çerdhe fëmijësh.

Kamenica ka një radiostacion, i cili bën transmetimin e programeve në disa gjuhë, si dhe tri radiostacione që transmetojnë kryesisht muzikë. Qyteti ka gazetarët e vet që raportojnë rregullisht për të përditshmet tona kosovare.

## 1.3 Historiku

Koha e saktë e themelimit të Kamenicës si vendbanim nuk dihet, por duhet të jetë së paku aty nga mesjeta. Kjo përmendet në librin e borxhlinjve të Mikel Llukarit në vitet '30-të të shek XV me emrin Chameniza, pastaj edhe në defterët turk të vitit 1455. Varësisht prej organizimeve të ish pushtet jugosllav ajo shpesh ishte komunë, por shpesh është trajtuar edhe si komunë e Qarkut të Gjilanit. Në vitin 1952 nga Qarku i Gjilanit, formohen tri rrethe: Gjilani, Kamenica dhe Vitia. Në vitin 1959 kur transformohen rrethet, Kamenica shndërrohet në komunë të pavarur, si njësi e barabartë me komunat tjera në vend. Me procesin e decentralizimit, Komunës së Kamenicës iu ka shkëputur një pjesë e territorit me 18 fshatra. Nga 13 fshatrat është krijuar komuna e re e Ranillugut në vitin 2010, si dhe 5 fshatra iu bashkangjiten komunës së Novobërdës.

## **1.4 Mekanizmat e pjesëmarrjes qytetare në nivel lokal**

Kuvendi i Komunës së Kamenicës, më 31 tetor të vitit 2012, ka aprovuar rregulloren për Organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Kamenicës. Kjo rregullore rregullon mënyrën e organizimit dhe bashkëpunimit midis komunës, fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane duke formuar këshilla lokale si trupa mbështetës të organeve të komunës, dhe që të ndikoj në konsultime gjithëpërfshirëse, të cilat promovojnë dhe zhvillojnë transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes. Në bazë të kësaj rregulloreje Komuna e Kamenicës ka themeluar 27 Këshilla lokale.

Në vitin 2014 Komuna e Kamenicës ka themeluar Komitetin konsultativ për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, bazuar në Ligjin për vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Kamenicës dhe Udhëzimin Administrativ Nr.2008/10 për Organizimin dhe Funksionimin e Komiteteve Konsultative në Komuna. Vendimi për themelimin e Komitetit Konsultativ për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje është marrë nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, pas paraqitjes së kërkesës nga ATRC për themelimin e këtij komiteti.

## **2. PRIORITETET E BANORËVE**

ATRC ka identifikuar nevojat dhe rekomandimet e përgjithshme të banorëve të komunës së Kamenicës si dhe të të gjitha fshatrave dhe lagjeve brenda qytetit. ATRC gjithashtu, ka identifikuar nevojat dhe rekomandimet e përgjithshme të grave, të rinjve, personave me nevoja të veçanta dhe Këshillave lokale. Prioritetet e banorëve janë identifikuar nga ATRC, në bashkëpunim me komunën e Kamenicës dhe Komitetin Konsultativ për Pjesëmarrjen e Qytetarëve në Vendimmarrje, gjatë takimeve të zhvilluara me përfaqësues të Këshillave lokale, qytetarë, përfaqësueset e Grupit të grave, të Këshillit rinor lokal dhe organizatat joqeveritare që u shërbejnë këtyre grupeve.

### **2.1 REKOMANDIMET E PËRGJITHSHME TË BANORËVE TË KOMUNËS SË KAMENICËS**

- Të rritet bashkëpunimi i komunës me qytetarë.
- Të rregullohen anësoret e urës në Kamenicë, sepse paraqesin rrezik për banorët.
- Të investohet në zhvillimin e bujqësisë.
- Të ndërtohet strehimorja e pleqve në Kamenicë.
- Të lidhet Kamenica përmes autostradës me Prishtinën.

## **2.2 REKOMANDIMET E GRUPIT TË GRAVE TË KOMUNËS SË KAMENICËS**

- Të ketë përfshirje më të madhe të grave në pozitat dhe proceset vendimmarrëse në nivel lokal.
- Të ndërtohet një kopsht i fëmijëve në Roganë.
- Të renovohet kopshti i fëmijëve në Kamenicë.

## **2.3 REKOMANDIMET E PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA**

- Të krijohet qasje për personat me nevoja të veçanta, në trotuare, objekte dhe shkolla. Vetëm disa shkolla, si shkolla e mesme në Kamenicë dhe shkollat në fshatrat Lajqiq dhe Poliqë kanë qasje edhe për personat me nevoja të veçanta. Kurse, në shumicën e institucioneve në nivel lokal personat me nevoja të veçanta nuk kanë qasje.
- Të ndahet objekti për shoqatën Handikos. Kuvendi i Komunës ka aprovuar kërkesën e Handikos, por ende nuk është ndarë objekti.

## **2.4 REKOMANDIMET E TË RINJVE**

- Të investohet në rregullimin e Qendrës rinore në Kamenicë. Të rregullohet mbuloja; të bëhet renovimi i objektit ekzistues; të sigurohen kompjuter dhe paisje tjera të nevojshme për funksionalizimin e kësaj qendre.
- Të ndërtohen Qendra rinore, në secilin prej këtyre fshatrave: Roganë, Hogosht, Muçivërc, Karaçevë e Ulët, Strezoc, Koretin, Topanicë, Petroc si dhe të sigurohen kompjuter dhe paisje tjera të nevojshme.
- Të rregullohet objekti për një qendër rekreative në fshatin Gmicë, e cila do të mundësonte organizimin e aktiviteteve të ndryshme të të rinjve të komunës së Kamenicës dhe të nivelit nacional.
- Të zhvillohet dhe të përkrahet Sektori i Rinisë, i cili funksionon në kuadër të DKRS-së, në mënyrë që të fitoj një forcë vepruese në të mirë të të rinjve të komunës së Kamenicës. Të krijohet një kod ose nënkod buxhetor si dhe të planifikohet dhe ndahet buxheti vjetor për këtë sektor, me të cilin do të realizoheshin objektivat e sektorit, të cilat janë në përputhje me strategjinë zhvillimore të rinisë në nivel nacional.
- Të sigurohen kushte pune për sektorin e rinisë (të sigurohen tavolina pune, printer, karrige, fotokopje dhe foto aparat).
- Ndarja e buxhetit për implementimin e Planit të Veprimit rinor lokal të Kamenicës.
- Të financohen projektet e OJQ-ve rinore, që janë në përputhje me Strategjinë Zhvillimore të Rinisë në Kosovë.
- Të licencohet një qendër rinore dhe e njëjta të financohet për zhvillimin e e aktiviteteve në dobi të të rinjve të Kamenicës. Ligji Nr. 03/L-145 për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë i obligon Komunitetet për licencimin e një qendreje rinore.
- Të përkrahet Këshilli Lokal i Veprimit Rinor - KVRL, në mënyrë që ky këshill ekzistues të funksionoj dhe të veproj pa vështërsi në jetësimin e objektivave të tij.

- Të sigurohen paga mesatare për secilin zyrtar, i cili do të punoj në zyrën e çdo qendrije dhe të KVRL-së.

## **2.5 REKOMANDIMET E PËRFAQËSUESVE TË KËSHILLAVE LOKALE**

- Të paisen me vula të gjitha Këshillat lokale.
- Të krijohen kushte pune dhe të sigurohet pagesa për përfaqësuesit e Këshillave lokale. Komuna do të duhej të ndante një linjë buxhetore për funksionimin më të mirë të Këshillave lokale.
- Të informohen Kryetarët e Këshillave lokale për projektet që implementohen në lokalitetet e tyre.
- Të bëhet informimi nga Komuna për kërkesat e dërguara nga Këshillat lokale në Komunë.

## **3. KAMENICË - QENDRA**

### **3.1 Pasqyra e përgjithshme**

Infrastruktura rrugore në qendër të Kamenicës është e mirë, megjithatë problem për banorët paraqet mosmirëmbajtja e qytetit, si pastrimi, ujitja e hapsirave gjelbëruese, etj. Qendra e qytetit të Kamenicës është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit, por furnizimi me ujë nuk është i rregullt.

Në lagjen Qendra është një shkollë fillore, në të cilën vijojnë mësimin edhe nxënësit e lagjeve tjera. Megjithatë, kjo shkollë është shumë e vjetër dhe nuk i plotëson kushtet për zhvillimin e mësimi. Veç tjerash, në shkollë mungon rrjeti i kanalizimit dhe toaletet janë në gjendje shumë të keqe.

Një tjetër problem i ngritur nga banorët është edhe sera prej 8 hektarësh, e cila tani shfrytëzohet vetëm për hudhjen e mbeturinave. Kjo hapsirë ka mbetur e pashfrytëzuar për shkak të problemeve pronësore. Banorët kanë ngritur disa herë problemin te institucionet përkatëse, por deri më tani nuk është ndërmarrë asgjë.

Qendra e qytetit të Kamenicës ka një park, por banorët kërkojnë që parku të rregullohet në kodrën afër Kamenicës.

### **3.2 Rekomandimet e banorëve:**

- Të sigurohet furnizimi i rregullt me ujë.
- Të asfaltohet një pjesë e rrugës Fehmi Agani.
- Të vendosen kamerat e sigurisë në qendër të qytetit.

- Të largohet sera nga qyteti, pasi rrezikon shëndetin e qytetarëve.
- Të rregullohet parkingu te ndërtesa Katrorja, në qendër të qytetit.
- Të pastrohen mbeturinat prapa ndërtesës së Shtëpisë së kulturës.
- Të ndalohet komunikacioni në një pjesë të rrugës Skenderbeu.
- Të rregullohet parku në kodrën afër Kamenicës.
- Të mirëmbahen më mirë rrugët dhe hapsirat gjelbëruese.



*Kryetari i Komunës së Kamenicës dhe Kryesuesi i Komitetit konsultativ për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje në takim me përfaqësuesit e Këshillave lokale për identifikimin e nevojave të qytetarëve të organizuar nga ATRC*

## 4. KAMENICË – LAGJA ILIRIA

### 4.1 Pasqyra e përgjithshme

Infrastruktura rrugore në lagjen Iliria është pjesërisht e mirë. Disa rrugë, si rruga Adem Jashari nr.7, Adem Jashari nr.8 dhe rruga prej stadionit deri te rruga Adem Jashari nr.1 nuk janë të asfaltuara. Lagja Iliria është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit, megjithatë furnizimi me ujë nuk është i rregullt. Gjendja më e keqe në këtë lagje është në rrugën Ramadan Kastrati, në të cilën rrjeti i ujësjellësit dhe i kanalizimit janë shumë të vjetër dhe gjithashtu mungon asfaltimi i rrugëve. Banorët kanë ngritur edhe problemin e mungesës së trotuarit në rrugën e sipërme, prej shkollës së mesme deri në fshatin Berivojcë.

Nxënësit e lagjes Iliria vijojnë mësimin në shkollën në lagjen Qendra, por kjo shkollë nuk i plotëson kushtet për zhvillimin e mësimin. Në lagjen Iliria ndodhet edhe stadioni, i cili nuk është në gjendje të mirë edhe pas disa investimeve të bëra në të.

## 4.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të përmirësohet furnizimi me ujë.
- Të rregullohet rrjeti i kanalizimit, rrjeti i ujësjellësit dhe të asfaltohet rruga Ramadan Kastrati.
- Të asfaltohen rrugët: Në rrugën Adem Jashari nr.7 të asfaltohet rruga me gjatësi 104 metra; Të asfaltohet rruga prej stadionit deri te rruga nr.1 Adem Jashari; Të asfaltohet rruga Adem Jashari nr. VIII, me gjatësi 130 metra. Në këto rrugë gjithashtu, paraqiten probleme gjatë reshjeve, pasi kanali i ujërave atmosferik është rregulluar vetëm deri në fund të lagjes.
- Të rregullohet trotuari i rrugës së sipërme, prej shkollës së mesme deri në fshatin Berivojcë.
- Të vendoset ndriçimi edhe në disa rrugë të lagjes Iliria.
- Të vendosen shenjat e komunikacionit në rrugën te shkolla e mesme. Së paku në 100 metra mungon vendkalimi dhe shenjëzimet.
- Të mirëmbahet stadioni si dhe të vendoset ndriçimi dhe të rregullohen shkallët.

## 5. KAMENICË – LAGJA QAMËRIA

### 5.1 Pasqyra e përgjithshme

Banorët e lagjes Qamëria në Kamenicë ballafaqohen me probleme të shumta, megjithatë problemi kryesor dhe që kërkon zgjidhje urgjente është parandalimi i rrëshqitjes së dheut te kodra. Ky problem është paraqitur edhe gjatë identifikimit të nevojave të banorëve nga ATRC në vitin 2013 dhe gjithashtu banorët kanë njoftuar në vazhdimësi Komunën. Për shkak të mosmarrjes së masave shtëpitë kanë filluar të dëmtohen dhe një pjesë e familjeve janë larguar. Nga rrëshqitja e dheut në këtë pjesë janë të rrezikuar rreth 30-40 familje.

Infrastruktura rrugore në lagjen Qamëria nuk është e mirë. Vetëm rruga regionale që lidh Kamenicën me Prishtinën është e asfaltuar, por megjithatë edhe ajo në masë të madhe është dëmtuar. Gjithashtu, katër rrugët tjera janë në gjendje jo të mirë.

Lagja Qamëria është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit, por gypat e ujësjellësit janë shumë të vjetër. Ndonëse, në një pjesë janë vendosur gypat e rinj, në rreth 500 metra të rrjetit të ujësjellësit nuk janë ndërruar gypat. Gjithashtu, furnizimi me ujë në këtë lagje nuk është i rregullt.

Rrjeti i kanalizimit në këtë lagje është rregulluar para disa vitesh, por banorët nuk kanë qenë të kënaqur me investimet e bëra në këtë rrjet. Banorët e lagjes së bashku me Komunën kanë bërë ankesë dhe lënda është në procedurë gjyqësore.

Në lagjen Qamëria mungon edhe ndriçimi publik. Ndriçimi publik ka qenë i vendosur vetëm në rrugën kryesore, por tani edhe ai është dëmtuar.

## 5.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të merren masa për parandalimin e rrëshqitjes së dheut te kodra. Rreth 30-40 familje në këtë pjesë janë të rrezikuara nga rrëshqitja e dheut.
- Të asfaltohet rruga kryesore dhe katër rrugët tjera në këtë lagje.
- Të ndërrohen gypat e ujësjellësit dhe të përmirësohet furnizimi me ujë.
- Të vendoset ndriçimi publik.
- Të vendoset rrethoja dhe të pastrohet e mirëmbahet hapsira te varrezat.
- Të ndërtohet fusha e sportit.
- Të largohen mbeturinat e ngurta. Në hyrje të lagjes hudhen mbeturina të ngurta dhe ato nuk largohen gjatë mbledhjes së mbeturinave tjera.



*Nënkryetari i Komunës, Kryesuesi dhe anëtarët e Kuvendit në punëtorinë e mbajtur nga ATRC*

## 6. KAMENICË – LAGJA MALËSIA

### 6.1 Pasqyra e përgjithshme

Infrastruktura rrugore në lagjen Malësia të Kamenicës është pjesërisht e mirë. Rruga kryesore e lagjes është e asfaltuar, por ka disa rrugë lokale që nuk janë të asfaltuara. Gjithashtu, trotuari në rrugën kryesore nuk është rregulluar. Rregullimi i trotuarit në këtë rrugë ka filluar në vitin 2013, megjithatë punimet ishin ndërprerë dhe gjendja ka mbetur e njejtë. Trotuari në këtë lagje mungon edhe te shkolla, duke rrezikuar kështu nxënësit që shkojnë në shkollë.

Banorët kanë probleme me rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit. Rrjeti i ujësjellësit dhe i kanalizimit në lagjen Malësia është vendosur vetëm në disa pjesë të lagjes. Gjithashtu, një pjesë

e lagjes që është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit rrezikohet nga ujërat e zeza, për shkak të mungesës së rrjetit të kanalizimit.

Banorët e lagjes theksojnë se në lagjen e tyre që një vit e gjysmë kanë munguar investimet. Sipas tyre i vetmi investim ka qenë rregullimi i kulmit të shkollës, edhe pse shkolla ka qenë e re por, punimet në kulm nuk janë bërë si duhet. Në lagje është i vendosur ndriçimi publik, megjithatë ndriçimi nuk funksionon si duhet.

## **6.2 Rekomandimet e banorëve**

- Të vendoset rrjeti i ujësjellësit dhe i kanalizimit edhe në disa pjesë të lagjes. Gjendja më e keqe është në një pjesë, e cila është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit por jo edhe me rrjetin e kanalizimit. Sipas banorëve uji i pijes është i ndotur nga ujërat e zeza.
- Të vazhdoen punimet në rregullimin e trotuarit në rrugën kryesore dhe gjithashtu, të ndërtohet trotuari në rrugën të shkollës.
- Të rregullohen rrugët lokale.
- Të ndërtohet fusha e sportit.

## **7. KËSHILLI I FSHATRAVE STREZOC**

### **7.1 Pasqyra e përgjithshme**

Këshilli i fshatrave Strezoc përfshin shtatë fshatra: Strezoc, Krilevë, Leshtar, Vaganesh, Gragjanik, Rahovicë, Popullant. Në këto fshatra janë rreth 300 shtëpi, në të cilat veç shqiptarëve jetojnë edhe komunitetet serb dhe rom. Në kohët e fundit në këto fshatra nuk është bërë asnjë investim, veç rregullimit të një rruge në fshatin Strezoc.

Infrastruktura rrugore në fshatra, në përgjithësi, nuk është e mirë. Në fshatin Strezoc ka qenë e asfaltuar rruga kryesore, e cila e lidh fshatin me Kamenicën dhe Prishtinën dhe gjithashtu rruga nga fshati Strezoc deri te shkolla. Megjithatë, në këtë fshat ka ende rrugë lokale të paasfaltuara. Në fshatin Leshtar rruga kryesore është në gjendje të keqe dhe sidomos gjatë stinës së dimrit vështirë e kalueshme. Banorët e fshati Krilevë ndihen të anashkaluar, meqë nuk është bërë asnjë investim. Rrugët në këtë fshat nuk janë në gjendje të mirë dhe gjithashtu duhet të rregullohet ura te lumi i fshatit. Rruga që kalon në Gragjanik dhe Rahovicë dhe që lidhet me Prishtinën nuk është në gjendje të mirë. Në fshatin Rahovicë rruga rreth 2 km. nuk është e rregulluar, duke shkaktuar vështirësi për banorët në punimin e tokave të tyre.

Veç infrastrukturës jo të mirë rrugore, asnjë nga shtatë fshatrat nuk janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit dhe atë të kanalizimit. Ujërat e zeza derdhen në lum, me ç'rast mundësitë e epidemive janë të mëdha. Fshatrat gjithashtu, nuk kanë ndriçim publik.

Këshilli i fshatit Strezoc ka tri shkolla fillore, të cilat ndodhen në fshatrat: Strezoc, Krilevë dhe Popullant. Sa i përket kushteve në shkolla vetëm shkolla në Popullant, në të cilën ndjekin



mësimin nxënësit e komunitetit serb, është e re dhe i plotëson kushtet për zhvillimin e mësimi. Shkolla në Strezoc nuk ka rrethojë, dritaret janë të vjetra, nuk ka sallë sportive, nuk ka kabinet të biologjisë dhe të kimisë, etj. Shkolla në Krilevë nuk ka sallë sportive, nuk ka kabinet të informatikës, të biologjisë dhe të kimisë, nuk ka ngrohje qendrore, dyshmeja në disa klasë është mjaft e dëmtuar dhe gjithashtu janë të dëmtuara dritaret dhe toaletet.

Me gjithë kushtet jo të mira në shkollë, nxënësit e fshatit Rahovicë ballafaqohen edhe me një tjetër problem. Ata duhet të udhëtojnë deri në 4 km., për të vijuar mësimin në fshatin Strezoc. Gjithashtu, nxënësit që shkojnë në shkollë të mesme në Kamenicë udhëtojnë nga Krileva rreth 20 km. Këshilli i fshatit Strezoc ka një objekt të Qendrës Rinore në fshatin Strezoc, por ky objekt është shumë i vjetër dhe nuk është funksional.

Fshati Strezoc ka një ambulantë, e cila ofron shërbime mjekësore çdo ditë, kurse në fshatin Krilevë gjithashtu është një ambulantë, por e cila funksionon vetëm një herë në javë. Që të dy ambulatat janë në gjendje të mirë, pasi janë renovuar gjatë vitit 2013.

## **7.2 Rekomandimet e banorëve:**

- Të vendoset rrjeti i kanalizimit. Asnjë nga fshatrat nuk janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit.
- Të vendoset rrjeti i ujësjellësit. Asnjë nga fshatrat nuk janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit.
- Të sigurohet transporti për nxënësit e fshatit Rahovicë; Të sigurohet transporti për nxënësit që shkojnë në shkollë të mesme në Kamenicë. Nxënësit nga fshati Krilevë udhëtojnë rreth 20 km., deri në Kamenicë.
- Të investohet në rregullimin e infrastrukturës rrugore: Të rregullohen rrugët në fshatin Krilevë dhe ura te lumi i fshatit; Të rregullohet rruga kryesore në fshatin Leshtar. Kjo rrugë është në gjendje mjaft të keqe dhe vështirë e kalueshme, sidomos gjatë stinës së dimrit; Të asfaltohet rruga që kalon në Gragjanik-Rahovicë dhe që lidhet me Prishtinën; Të shtrohet me zhavor rruga rreth 2 km. në fshatin Rahovicë. Mungesa e rregullimit të kësaj rruge shkakton vështirësi për banorët në punimin e tokave të tyre; Të rregullohen rrugët lokale në fshatin Strezoc.
- Të vendoset ndriçimi publik në të gjitha fshatrat.



*Nënkryetari i Komunës dhe anëtarët e Komitetit konsultativ për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje në punëtorinë e mbajtur nga ATRC*

## 8. KËSHILLI LOKAL MUÇIVËRC

### 8.1 Pasqyra e përgjithshme

Fshati Muçivërc ka rreth 300 shtëpi, me rreth 1700 banorë. Veç parkut të fshatit, i cili është rregulluar para disa vitesh, Komuna e Kamenicës ka bërë shumë pak investime në fshatin Muçivërc. Infrastruktura rrugore në fshat nuk është e mirë. Përveç rrugës që shpie në fshatin Dajkoc, asnjë nga rrugët tjera nuk janë të asfaltuara.

Mungesa e ujit konsiderohet ndër problemet kryesore të banorëve të fshatit. Fshati Muçivërc nuk është i lidhur me rrjetin e ujësjellësit dhe gjithashtu uji nga pusët nuk mund të përdoret për pije. Për këtë arsye, banorët e sigurojnë ujin e pijes nga fshatrat tjerë. Rrjeti i kanalizimit është rregulluar në një pjesë të fshatit, por ky rrjet mungon në ambulancë, stacionin e policisë, zyren e regjistrimit civil dhe të zjarrfikësve. Gjatësia e rrjetit të kanalizimit që duhet të rregullohet është rreth 300 metra.

Fshati ka një shkollë fillore, e cila është ndërtuar në vitin 2007. Ndër problemet tjera të banorëve janë edhe mosrregullimi i trotuarit, mungesa e lokalcionit të varrezave, mosvazhdimi i ndriçimit publik në fshat, mungesa e objektit të zjarrfikjes dhe shpëtimit, etj.

## 8.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të rregullohet çështja e ujit të pijes në fshat.
- Të lidhen me rrjetin e kanalizimit ambulanta, stacioni i policisë, zyra e regjistrimit civil, të zjarrfikësve dhe tri shtëpi. Gjithashtu, të rregullohet kanalizimi afër shkollës.
- Të investohet në rregullimin e rrugëve të fshatit.
- Të vazhdohet trotuari nga Muhaxherët deri te pompa e benzinës.
- Të caktohet lokacioni i varrezave dhe të vendoset rrethoja e asaj pjese.
- Të vazhdohet vendosja e ndriçimit publik.
- Të vendoset rrethoja e parkut në Muçivërc.
- Të zgjidhet çështja e ujërave atmosferike, sepse gjatë reshjeve uji hyn nëpër shtëpi.

## 9. KËSHILLI I FSHATIT DAJKOC

### 9.1 Pasqyra e përgjithshme

Këshilli i fshatit Dajkoc përfshin vetëm fshatin Dajkoc. Infrastruktura rrugore në fshat nuk është e mirë. Rruga kryesore në fshat është asfaltuar para disa vitesh, megjithatë banorët nuk janë të kënaqur me punimet që janë bërë në këtë rrugë. Kjo rrugë është shumë e ngushtë si dhe nuk ka trotuar. Në fshat ka gjithashtu rrugë lokale që nuk janë të rregulluara.

Në vitin 2013 në fshat është vendosur rrjeti i ujësjellësit, projekt ky i cili është implementuar në disa fshatra të Komunës së Kamenicës. Megjithatë, banorët nuk janë aspak të kënaqur me punimet që janë bërë në vendosjen e rrjetit të ujësjellësit. Problemet me rrjetin e ujësjellësit janë në veçanti të shprehura në qendër të fshatit si dhe në disa pjesë të rrugëve, të cilat janë dëmtuar gjatë punimeve dhe nuk janë rregulluar. Për këtë qëllim, banorët kërkojnë që Komuna të rishikoj punimet që janë bërë në rrjetin e ujësjellësit dhe të merren masa për rregullimin e tyre.

Banorët kanë probleme edhe me ujërat e zeza, pasi fshati nuk është i lidhur me rrjetin e kanalizimit.

Fshati ka një shkollë, e cila i plotëson pjesërisht kushtet për zhvillimin e mësimin. Në këtë shkollë nxënësit vijojnë mësimin deri në klasën e pestë.

### 9.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të bëhet zgjerimi i rrugës kryesore si dhe të ndërtohet trotuari. Kjo rrugë lidh fshatin Dajkoc me fshatin Muçivërc.

- Të bëhet ndërrimi i dritareve të shkollës dhe renovimet tjera të nevojshme. Gjithashtu, të rregullohet hapsira për zhvillimin e mësimi parashkollor.
- Të vendoset rrjeti i kanalizimit në fshat.
- Të ndërtohet një sallë për zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe takimeve të ndryshme për nevojat e banorëve.
- Të ndërtohet një ambulantë.

## **10. KËSHILLI I FSHATIT RUBOC**

### **10.1 Pasqyra e përgjithshme**

Infrastruktura rrugore në fshat është pjesërisht e mirë. Rruga kryesore është e asfaltuar, megjithatë në këtë rrugë mungon trotuari. Mungesa e trotuarit në këtë rrugë paraqet rrezik në veçanti për nxënësit, të cilët udhëtojnë deri në Kamenicë. Fshati Ruboc ka gjithashtu rrugë lokale të parregulluara dhe në veçanti dy prej tyre janë në gjendje më të keqe dhe paraqesin problem për banorët.

Rrjeti i ujësjellësit është vendosur në fshat, por me këtë rrjet nuk janë të lidhura të gjitha lagjet. Fshati është i lidhur me rrjetin e kanalizimit. Rrjeti i kanalizimit në fshat është vendosur gjatë vitit 2012, megjithatë gjatë vendosjes së këtij rrjeti janë bërë disa dëmtime, të cilat nuk janë rregulluar në fund të projektit.

Në fshatin Ruboc është vendosur ndriçimi publik gjatë vitit të kaluar. Fshati nuk ka shkollë fillore dhe ambulantë, por kjo nuk paraqet ndonjë problem për banorët pasi distanca e fshatit nga Kamenica është rreth 3 km.

### **10.2 Rekomandimet e banorëve:**

- Të lidhen me rrjetin e ujësjellësit edhe lagjet tjera të fshatit.
- Të ndërtohet trotuari në rrugën kryesore. Kjo rrugë lidh fshatin Ruboc me Kamenicën dhe mungesa e trotuarit paraqet rrezik, në veçanti për nxënësit.
- Të rregullohen dy rrugë lokale në fshat.
- Të rregullohen dëmtimet të cilat janë bërë gjatë vendosjes së rrjetit të kanalizimit.
- Të zgjidhet çështja e rrugës, përmes së cilës banorët e dy lagjeve shkojnë deri te varrezat dhe e cila është pronë private.



*Anëtarët e Komitetit konsultativ për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje në punëtorinë e mbajtur nga ATRC*

## **11. KËSHILLI I FSHATIT KARAÇEVË E EPËRME**

### **11.1 Pasqyra e përgjithshme**

Infrastruktura rrugore në fshat është pjesërisht e mirë. Disa nga rrugët e fshatit janë të asfaltuara, megjithatë ka ende rrugë lokale të parregulluara. Në lagjen e Selishtëve, ku jetojnë rreth 20 familje, rruga me gjatësi 2 km. nuk është e rregulluar dhe është në gjendje shumë të keqe. Kërkesë e banorëve është që të paktën kjo rrugë të shtrohet me zhavor. Kjo rrugë paraqet vështirësi sidomos për nxënësit, që shkojnë në shkollë. Një tjetër problem për nxënësit paraqet edhe mospajtimi i transportit.

Fshati Karaçevë e Epërme nuk është i lidhur me rrjetin e ujësjellësit. Banorët e sigurojnë ujin e pijes kryesisht përmes puseve. Gjithashtu, fshati nuk është i lidhur me rrjetin e kanalizimit si dhe ndriçimi publik nuk është vendosur në tërë fshatin.

Fshati ka një shkollë fillore, por kushtet brenda shkollës nuk janë të mira. Në pjesën e brendshme të shkollës nuk është investuar që 15 vite dhe gjithashtu duhet të vendoset një mur mbrojtës jashtë shkollës, pasi shkolla gjendet rrëzë një bregu. Fshati ka një ambulantë megjithatë, në ambulantë nuk ka ujë.

Në lagjen e Hajdutëve të fshatit Karaçevë e Epërme gjithashtu duhet të vendosen gypat e ujërave atmosferik.

### **11.2 Rekomandimet e banorëve:**

- Të rregullohet çështja e ujit të pijes në fshat.
- Të lidhet fshati me rrjetin e kanalizimit.
- Të asfaltohet ose të shtrohet me zhavorr rruga me gjatësi 2 km., në lagjen e Selishtëve. Gjithashtu, të rregullohen edhe gjashtë rrugë lokale të fshatit.
- Të investohet në rregullimin e brendshëm të shkollës dhe të vendoset muri mbrojtës, pasi shkolla gjendet rrëzë një bregu. Kushtet brenda shkollës nuk janë të mira. Në pjesën e brendshme të shkollës nuk është investuar që 15 vite.
- Të vazhdohet vendosja e ndriçimit publik në fshat.
- Të vendosen gypat e ujërave atmosferik në lagjen e Hajdutëve.

## **12. KËSHILLI I FSHATIT KARAÇEVË E POSHTME**

### **12.1 Pasqyra e përgjithshme**

Infrastruktura rrugore në fshat është pjesërisht e mirë, megjithatë ka rrugë lokale të cilat nuk janë të rregulluara. Gjithashtu, rruga nga Dheu i bardhë deri në Karaçevë, që i lidh rreth 15 fshatra është e parregulluar.

Fshati Karaçevë e poshtme është i lidhur me rrjetin e ujësjellësit, megjithatë në ambulantë të fshatit ka mungesë të ujit. Gjithashtu, në fshat është rregulluar rrjeti i kanalizimit, por ky rrjet nuk funksionon si duhet.

Fshati ka një shkollë fillore, e cila deri diku i plotëson kushtet për zhvillimin e mësimin. Fshati Karaçevë e poshtme ka një ambulantë, por banorët ka disa vite që bëjnë kërkesë në Komunën e Kamenicës për ndërtimin e një objekti të ri të ambulantes.

### **12.2 Rekomandimet e banorëve**

- Të rregullohet rrjeti i kanalizimit në fshatin Karaçevë e poshtme.
- Të rregullohet rrjeti i ujësjellësit.
- Të rregullohet shtrati i lumit, rreth 3km.
- Të rregullohet rruga në Karaçevë.

- Të ndërtohet objekti i ri i ambulantës. Deri sa të ndërtohet objekti i ri, të rregullohet çështja e ujit në objektin ekzistues.
- Të vendoset ndriçimi publik.
- Të renovohet objekti i Shtëpisë së Kulturës.
- Të largohen qentë endacak.

## **13. KËSHILLI I FSHATRAVE AJNOVC**

### **13.1 Pasqyra e përgjithshme**

Këshilli i fshatrave Ajnovc përfshin fshatrat: Ajnovc, Reçan i poshtëm, Reçan i epërm dhe Meshinë. Infrastruktura rrugore në fshatra është pjesërisht e mirë: në fshatin Ajnovc rrugët janë të rregulluara, kurse në fshatin Meshinë rreth 800 metra rrugë nuk është e asfaltuar dhe gjithashtu në Reçan të poshtëm dhe Reçan të epërm nuk janë rregulluar dy rrugë nga 300 metra. Banorët e fshatit Reçan ballafaqohen edhe me mungesë të ujit.

Problem të madh për banorët paraqet mungesa e rrjetit të kanalizimit. Asnjë nga fshatrat nuk është i lidhur me rrjetin e kanalizimit dhe të gjitha ujërat e zeza derdhen në lum.

Këshilli i fshatrave Ajnovc ka një shkollë fillore dhe gjithashtu një ambulantë.

### **13.2 Rekomandimet e banorëve:**

- Të rregullohet çështja e ujit të pijes në fshatin Reçan.
- Të vendoset rrjeti i kanalizimit në të gjitha fshatrat.
- Të rregullohet rruga rreth 800 metra në fshatin Meshinë dhe gjithashtu rrugët nga 300 metra në fshatrat Reçan i poshtëm dhe Reçan i epërm.
- Të rregullohet ura për këmbësor.





*Kryetari i Kuvendit të Komunës së Kamenicës në konferencën regjionale të mbajtur nga ATRC*

## **14. KËSHILLI I FSHATIT ROGANË**

### **14.1 Pasqyra e përgjithshme**

Fshati Roganë ka rreth 600 shtëpi. Infrastruktura rrugore në fshatin Roganë është deri diku e mirë, megjithatë ka disa rrugë që nuk janë të asfaltuara: Rruga prej shkollës deri në Fshatin e ri; rruga prej trafos së mesme deri te tyrbja dhe rruga prej shkollës deri te bregu (mbi shkollë), me gjatësi rreth 300 metra. Problem më të madh sipas banorëve paraqet rruga prej shkollës deri në Fshatin e ri, në të cilën nga klasa e nëntë vijnë mësimin edhe nxënësit e fshatrave të Komunës së Bujanocit.

Pjesa më e madhe e fshatit është e lidhur me rrjetin e kanalizimit, por disa lagje në fshat nuk janë të lidhura me këtë rrjet. Në fshat është investuar në rregullimin e rrjetit të ujësjellësit, megjithatë vendosja e këtij rrjeti nuk ka përfunduar.

Fshati ka një ambulantë dhe një shkollë fillore, e cila është rregulluar kohët e fundit me përkrahjen e donatorëve. Në Roganë është objekti i vjetër së Shtëpisë së Kulturës, i cili nuk është në gjendje të mirë.



## 14.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të përfundohet vendosja e rrjetit të ujësjellësit në fshat. Në rreth 30 % të fshatit nuk është vendosur rrjeti i ujësjellësit.
- Të vendoset rrjeti i kanalizimit edhe në disa pjesë të fshatit.
- Të ndërtohet një kopsht i fëmijëve.
- Të investohet në rregullimin e infrastrukturës rrugore: Të asfaltohet rruga prej shkollës deri në fshatin e ri; Të asfaltohet rruga prej trafos së mesme deri te tyrbja; Të asfaltohet rruga prej shkollës deri te bregu (mbi shkollë), me gjatësi rreth 300 metra. Problem më të madh paraqet rruga prej shkollës deri në Fshatin e ri, në të cilën nga klasa e nëntë vijnë mësimin edhe nxënësit e fshatrave të Komunës së Bujanocit.
- Të renovohet Shtëpia e Kulturës, e cila është në gjendje shumë të keqe.
- Të vendoset ndriçimi publik në lagjen e Krenidellëve, lagjen e Rrudhanëve dhe në rrugën prej Bekteshve deri mbi shkollë. Banorët gjithashtu shprehin pakënaqësi për mosmirëmbajtjen e ndriçimit publik ekzistues.
- Të rregullohet çështja pronësore e një pjese të kanalit të ujit.

## 15. KËSHILLI I FSHATRAVE BOSÇË

### 15.1 Pasqyra e përgjithshme

Këshilli i fshatrave Bosçë përfshin fshatrat: Bosçë, Grizimë, Strelicë, Moqar i epërm, Moqar i poshtëm dhe Kostadincë. Sipas banorëve, investimet e bëra në këto fshatra nuk kanë qenë të mjaftueshme.

Infrastruktura rrugore në fshatra nuk është e mirë. Në fshatin Kostandincë rruga kryesore nuk është e asfaltuar dhe gjithashtu në fshatin Grizimë, rruga rreth 800 metra, e cila lidh lagjen e shqiptarëve me lagjen e serbëve nuk është e rregulluar. Në fshatin Bosçë, përveç asfaltimit të një rruge nuk ka patur asnjë investim tjetër. Në fshatin Moqar i poshtëm është asfaltuar rreth 500 metra rrugë, megjithatë edhe pse fshati është vetëm 1 km në largësi nga Kamenica ai nuk është i lidhur me rrjetin e kanalizimit dhe as me rrjetin e ujësjellësit. Rrjeti i ujësjellësit dhe ai i kanalizimit mungon edhe në pesë fshatrat tjerë të Këshillit të fshatrave Bosçë.

Në fshatin Bosçë është shkolla fillore, në të cilën vijnë mësimin nxënësit e fshatrave: Bosçë, Grizimë, Strelicë dhe Kostadincë. Kurse, nxënësit e fshatit Moqar vijnë mësimin në Kamenicë. Këto fshatra kanë një ambulantë, e cila ofron shërbime mjekësore për banorët e të gjitha fshatrave.

## **15.2 Rekomandimet e banorëve:**

- Të rregullohet rrjeti i ujësjellësit në të gjitha fshatrat.
- Të rregullohet rrjeti i kanalizimit në të gjitha fshatrat.
- Të investohet në rregullimin e infrastrukturës rrugore: Të asfaltohet rruga Moqar i epërm dhe Moqar i poshtëm, me të cilën rrugë lidhen katër fshatra; Të rregullohet rruga prej 250 metra në fshatin Strelisë; Të rregullohet rruga në fshatin Kostadinë; Të rregullohet rruga, me gjatësi rreth 800 metra, në fshatin Grizimë. Kjo rrugë lidh lagjen e shqiptarëve me lagjen e serbëve.

## **16. KËSHILLI I FSHATIT BUSAVATË**

### **16.1 Pasqyra e përgjithshme**

Infrastruktura rrugore në fshatin Busavatë është pjesërisht e mirë. Rruga kryesore e fshatit është e asfaltuar, por 4-5 rrugë lokale nuk janë të rregulluara.

Ndër problemet kryesore të banorëve janë mungesa e rrjetit të ujësjellësit dhe mospërfundimi i rrjetit të kanalizimit. Në mungesë të rrjetit të ujësjellësit banorët e sigurojnë ujin e pijes në mënyrë individuale, kryesisht përmes puseve, gjë që paraqet problem mjaft të madh për banorët. Sa i përket rrjetit të kanalizimit, ai ka filluar të vendoset gjatë vitit 2013, megjithatë nuk kishte përfunduar dhe gjendja ka mbetur akoma e njëjtë.

Fshati ka një shkollë fillore, por shkolla nuk i plotëson kushtet për zhvillimin e mësimin dhe ka mungesë të ujit. Në këtë shkollë vijojnë mësimin rreth 200 nxënës, një pjesë e cilëve udhëtojnë rreth 7 km. Fshati ka një ambulantë, e cila gjithashtu ka mungesë të ujit.

Mungesa e rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit në fshat, por edhe në ambulantë dhe në shkollë paraqet rrezik për infeksione të ndryshme. Ujërat e zeza të fshatit në derdhen në ambient të hapur.

### **16.2 Rekomandimet e banorëve:**

- Të vendoset rrjeti i ujësjellësit në fshat.
- Të përfundohet vendosja e rrjetit të kanalizimit.
- Të rregullohen rrugët lokale.
- Të renovohet shkolla në fshat.



*Zyrtarët e Komunës dhe anëtarët e Komitetit konsultativ për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimarrje në punëtorinë e mbajtur nga ATRC*

## **17. KËSHILLI I FSHATRAVE HOGOSHT**

### **17.1 Pasqyra e përgjithshme**

Këshilli i fshatrave Hogosht përfshin fshatrat: Hogosht dhe Dazhnicë. Infrastruktura rrugore në fshatin Hogosht është e mirë, kurse në fshatin Dazhnicë rruga është me zhavor. Ndër problemet kryesore për banorët e fshatit Hogosht është mungesa e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit. Ndonëse, banorët e kanë rregulluar pjesërisht rrjetin e kanalizimit, ujërat e zeza derdhen në lum.

Fshati Hogosht ka një shkollë, në të cilën zhvillohet mësimi fillor dhe ai i mesëm. Megjithatë, kati i dytë i shkollës nuk i plotëson kushtet për mësim dhe gjithashtu, shkolla nuk ka nxemje qendrore. Në fshatin Dazhnicë është rregulluar rrjeti i ujësjellësit dhe objekti i shkollës, në të cilën nxënësit mund të ndjekin mësimin deri në klasën e pestë.

Në fshatin Hogosht ndodhet Shtëpia e shëndetit, Zyra e Vendit, biblioteka e fshatit dhe posta. Në fshat ndodhet edhe stacioni policor, por i cili pas vitit 1999 nuk funksionon.

## 17.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të vendoset rrjeti i kanalizimit dhe rrjeti i ujësjellësit.
- Të rregullohet infrastruktura rrugore: Të vazhdohet rregullimi i trotuarit prej urës deri te shkolla, me gjatësi rreth 50 metra; Të bëhet zgjerimi i rrugës nga fshati Hogosht deri në fshatin Dazhnicë e poshtme; Të bëhet asfaltimi i rrugës prej Zyres së vendit deri te lagja Gjacakaj; Të rregullohet rruga prej Urës së varrezave deri te lagja Hakaj.
- Të rregullohet rrjeti elektrik në disa lagje të fshatit: në një pjesë të fshatit duhet të ndërrohet rrjeti, kurse në pjesën tjetër duhet të rregullohet edhe tensioni i lartë.
- Të investohet në rregullimin e katit të dytë të shkollës dhe të oborrit.
- Të vendoset ndriçimi publik në disa lagje dhe të rregullohet ndriçimi publik ekzistues në lagjet tjera.
- Të zgjerohet shtrati i lumit dhe të rregullohet baseni te penda. Në këtë mënyrë do të parandalohen vërshimet gjatë reshjeve.
- Të pastrohen mbeturinat në fshatin Hogosht.
- Të rifunksionalizohet stacioni i policisë në fshat.
- Të mirëmbahet hapsira te varrezat: të bëhet pastrimi i varrezave dhe të mbillen drunjë.

## 18. KËSHILLI I FSHATRAVE BERIVOJCË

### 18.1 Pasqyra e përgjithshme

Këshilli i fshatrave Berivojcë përfshin fshatrat Berivojcë dhe Ogragjë. Problem kryesor për banorët e këtyre dy fshatrave është infrastruktura jo e mirë rrugore, mungesa e trotuareve dhe mungesa e ndriçimit. Në fshatin Berivojcë janë të asfaltuara vetëm rrugët kryesore, kurse fshati Ogragje është vend malor dhe rrugët janë me zhavor. Gjithashtu, veç rrugës kryesore në fshatin Berivojcë asnjë nga rrugët nuk ka ndriçim publik si dhe pas vitit 1999 asnjë nga trotuaret nuk është rregulluar. Mungesa e trotuareve në fshat rrezikon veç banorëve edhe nxënësit. Edhe pse banorët shpresojnë se së shpejti do të ketë investime në rregullimin e rrugëve, trotuareve dhe ndriçimit publik, deri më tani ato kanë munguar.

Rrjeti i ujësjellësit dhe i kanalizimit në fshatra është pjesërisht i rregulluar, pasi një lagje me rreth 60 banorë nuk është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit. Në fshat mundësohet mësimi i ciklit të ulët vetëm për nxënësit e komunitetit serb, kurse nxënësit shqiptar nga klasa e parë udhëtojnë nga 3 deri në 4 km deri në Kamenicë, ndërkohë që transporti për nxënës nuk sigurohet nga komuna. Fshatrat gjithashtu nuk kanë çerdhe për fëmijë dhe fushë sporti për të rinjtë.

Fshatrat Berivojcë dhe Ogragjë nuk kanë ambulantë. Për shërbime mjekësore banorët udhëtojnë 3 dhe 4 km., deri në Kamenicë. Banorët kanë probleme edhe me rrjetin elektrik, i cili veçanërisht në një lagje është shumë i vjetër.

## **18.2 Rekomandimet e banorëve:**

- Të vendoset rrjeti i ujësjellësit dhe i kanalizimit në një lagje të fshatit Berivojcë.
- Të asfaltohen rrugët lokale.
- Të rregullohen trotualet. Të rregullohet të paktën trotuari në rrugën Berivojcë - Koretin , me gjatësi rreth 400 metra.
- Të sigurohet transporti për nxënësit, të cilët nga klasa e parë udhëtojnë nga 3 deri në 4 km.
- Të bëhet rregullimi, pastrimi dhe mirëmbajtja e disa prrockave.
- Të rregullohet fusha e sportit.
- Të rregullohet ndiçimi në një pjesë të fshatit.

## **19. KËSHILLI I FSHATRAVE SHIPASHNICË E EPËRME**

### **19.1 Pasqyra e përgjithshme**

Fshati Shipashnicë e epërme ka rreth 2000 banorë. Në përgjithësi, në fshat ka patur mjaft investime, por në të cilat kanë kontribuar banorët e fshatit dhe bashkatdhetarët. Rruga me gjatësi 3 km, e cila kalon rreth fshatit, është rregulluar në vitin 2005 me 50 % investime nga vetë banorët. Megjithatë, për shkak të mbingarkesës kjo rrugë ka filluar të dëmtohet. Banorët, gjithashtu me vetëfinancim para disa vitesh kanë bërë rregullimin e rrugës brenda fshatit. Megjithatë, rreth 80% e rrugëve në fshat janë jofunksionale.

Fshati ka një shkollë, për rregullimin e së cilës banorët kanë investuar 10 000 euro. Kjo shkollë i plotëson kushtet për zhvillimin e mësimin dhe ka gjithashtu edhe fushë të sportit. Megjithatë, shkolla ka mungesë të sallës së edukatës fizike.

Ndër problemet kryesore të banorëve është mungesa e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit. Ndonëse, rrjeti i ujësjellësit në fshat ka filluar të rregullohet ai ka mbetur pa përfunduar. Edhe pse banorët e fshatit Shipashnicë e epërme kanë participuar me mjete financiare, arsyeja e ndërprerjes së punimeve në rrjetin e ujësjellësit është se ky projekt implementohet edhe në tre fshatra, të cilët nuk kanë participuar me mjete financiare. Gjithashtu, projekti për rregullimin e rrjetit të kanalizimit ka filluar para disa vitesh, mirëpo nuk ka përfunduar. Banorët shprehin pakënaqësi për mospërfundimin e rrjetit të kanalizimit, pasi që në fillim në këtë projekt nuk janë përfshirë 30-40 shtëpi të fshatit. Gjithashtu, gjatë rregullimit të rrjetit të kanalizimit

kompania ka shkaktuar disa dëme, si në rrjetin e ujësjellësit ashtu edhe në rrugë dhe askush nuk merr përgjegjësi për dëmet që janë shkaktuar gjatë vendosjes së këtij rrjeti.

Banorët e fshatit Shipashnicë e epërme kanë probleme edhe me ndotjen e ujit nga separacionet. Në fshatrat Lajcic dhe Desivojcë janë 4 separacione, të cilët e marrin zhavorrin nga lumi dhe e ndotin ujin. Pesë-gjashtë fshatra, të cilët furnizohen me ujë nga ky lum përdorin ujin e ndotur. Për zgjidhjen e këtij problemi banorët për shtatë vite radhazi kanë informuar të gjitha institucionet në nivel lokal dhe qendror, megjithatë deri më tani nuk është ndërmarrë asgjë.

Fshati ka ambulantë, e cila është renovuar kohët e fundit. Megjithatë, në këtë ambulantë nuk janë rregulluar shkallët. Banorët e fshatit kanë investuar edhe në rrethimin e hapsirës së varrezave. Në fshat është stadioni, por i cili tani nuk është funksional dhe kjo hapsë shfrytëzohet për hudhjen e mbeturinave. Banorët kanë përgaditur projektin me vlerë rreth 14 000 euro, për rregullimin e stadionit.

## **19.2 Rekomandimet e banorëve:**

- Të vazhdoj projekti për rregullimin e rrjetit të ujësjellësit.
- Të përfundohet rrjeti i kanalizimit. Të përfshihen edhe 30-40 shtëpi të fshatit në rrjetin e kanalizimit si dhe të rregullohen dëmet që janë shkaktuar gjatë vendosjes së këtij rrjeti. Gjatë vendosjes së rrjetit të kanalizimit janë shkaktuar dëme në rrjetin e ujësjellësit dhe në rrugë.
- Të zgjidhet problemi nga ndotja e ujit nga separacionet. Edhe pas shtatë vitesh që banorët i informojnë institucionet në nivel lokal dhe qendror për këtë problem ende nuk është ndërmarrë asgjë.
- Të asfaltohen katër rrugë lokale dhe të rregullohet rruga kryesore, e cila është dëmtuar.
- Të vendoset ndriçimi edhe në tri rrugë tjera të fshatit.
- Të shtohet një aneks në shkollë për rregullimin e sallës së sportit.
- Të vendoset një deponi e mbeturinave. Në fshat është caktuar vendi për deponinë e mbeturinave, por problem paraqet mosrregullimi i rrugës prej 300 m.



*Konferenca regjionale e mbajtur nga ATRC*

## **20. KËSHILLI I FSHATRAVE SHIPASHNICË E POSHTME**

### **20.1 Pasqyra e përgjithshme**

Këshilli i fshatit Shipashnicë e poshtme përfshin dy fshatra: Shipashnicë e poshtme dhe fshatin Kranidell, në të cilat jetojnë rreth 1200 banorë. Problemi kryesor për banorët e fshatit Shipashnicë e poshtme është mungesa e rrjetit të ujësjellësit. Shipashnica e poshtme është i vetmi fshat që nuk është përfshirë në projektin për vendosjen e rrjetit të ujësjellësit.

Fshati është i lidhur me rrjetin e kanalizimit. Ky rrjet është rregulluar gjatë viteve 2003-2004, me participim të komunës, banorëve dhe donatorëve.

Këshilli i fshatit Shipashnicë e poshtme ka një shkollë, e cila është ndërtuar kohën e fundit dhe i plotëson kushtet për zhvillimin e mësimi. Edhe banorët e fshatit Shipashnicë e poshtme janë të indinjuar për mosndërmarrjen e masave nga institucionet për ndotjen e ujit në lum nga separacionet.

## **20.2 Rekomandimet e banorëve të fshatit Shipashnicë e poshtme:**

- Të rregullohet rrjeti i ujësjellësit. Fshati Shipashnicë e poshtme është i vetmi fshat i cili nuk është përfshirë në projektin për vendosjen e rrjetit të ujësjellësit.
- Të pastrohet shtrati i lumit. Të merren masa nga institucionet për ndotjen e ujit në lum nga separacionet.
- Të rregullohen trotuaret. Rrugët në fshat janë të ngushta dhe mungesa e trotuareve paraqet rrezik në veçanti për nxënësit.
- Të renovohet objekti i shkollës së vjetër, i cili do t' mund të shfrytëzohej për aktivitete rinore dhe zyre të Këshillit lokal.
- Të shtohet një aneks në shkollë, për zhvillimin e mësimin parashkollor.
- Të bëhet ndërrimi i shtyllave elektrike në fshat. Shtyllat elektrike ekzistuese janë shumë të vjetra dhe paraqesin rrezik për banorët. Gjithashtu, disa lagje kanë probleme me furnizimin me energji elektrike.

## **20.3 Rekomandimet e banorëve të fshatit Kranidell:**

- Të vendoset rrjeti i kanalizimit dhe rrjeti i ujësjellësit në fshat.
- Të asfaltohet rruga me gjatësi 7 km.
- Të bëhet renovimi i shkollës. Kjo shkollë është ndërtuar pas vitit 1999, megjithatë një pjesë e shkollës është dëmtuar.
- Të rregullohet oborri i shkollës. Të vendoset rrethoja dhe të rregullohet terreni sportiv.

# **21. KËSHILLI I FSHATIT HODONOC**

## **21.1 Pasqyra e përgjithshme**

Fshati Hodonoc ka rreth 500 shtëpi, në të cilat jetojnë rreth 2000 banorë. Ndër problemet kryesore në fshatin Hodonoc është mosrregullimi i shtratit të lumit. Gjendja më e vështirë është sidomos gjatë reshjeve, kur edhe bllokohet rruga kryesore.

Rrugët lokale në fshatin Hodonoc gjithashtu, nuk janë të asfaltuara si dhe mungon ndriçimi publik në lagje. Rrjeti i kanalizimit në fshat është rregulluar, veç një lagjeje në të cilën nuk është rregulluar ky rrjet. Rrjeti i ujësjellësit është vendosur në fshat, por ky rrjet nuk ka përfunduar.



## 21.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të përfundohet rrjeti i ujësjellësit në fshat.
- Të vendoset rrjeti i kanalizimit në disa lagje.
- Të rregullohet kanali në rrugën kryesore, në mënyrë që të mos ndodhin vërshimet gjatë reshjeve.
- Të asfaltohen rrugët e lagjeve dhe të rregullohet ndriçimi publik.
- Të stimulohet sektori i pemtarisë, blegtorisë dhe bletarisë.
- Të zgjidhet çështja e mbeturinave.



*Anëtarët e Komitetit konsultativ për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje në punëtorinë e mbajtur nga ATRC*

## 22. KËSHILLI I FSHATRAVE POLIÇKË

### 22.1 Pasqyra e përgjithshme

Këshilli i fshatrave Poliçkë përfshin fshatrat: Poliçkë, Marocë, Vriçec dhe Velegllavë. Banorët e këtyre fshatrave nuk janë të kënaqur me kushtet e përgjithshme dhe ndihen të lënë anash nga

institucionet komunale. Për shkak të gjendjes së vështirë banorët braktisin fshatrat, për një jetë më të mirë në qytet.

Ndër problemet kryesore me të cilin ballafaqohen banorët e këtyre fshatrave është mungesa e rrjetit të kanalizimit. Gjendja më e vështirë është sidomos në fshatin Poliçkë, ku ujërat e zeza derdhen në ambient të hapur. Ujërat e zeza kalojnë pranë shtëpive dhe në fund derdhen në lum.

Infrastruktura rugore në fshatra nuk është e mirë. Jo vetëm rrugët lokale në fshatra, por edhe ruga kryesore, e cila i lidh fshatrat, me gjatësi 4.5 km., nuk është e asfaltuar dhe është në gjendje shumë të keqe. Fshatrat gjithashtu, nuk janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit. Këshilli i fshatrave ka shkollë fillore dhe gjithashtu një ambulantë.

## **22.2 Rekomandimet e banorëve:**

- Të vendoset rrjeti i kanalizimit në fshatra. Mungesa e rrjetit të kanalizimit rrezikon në veçanti banorët e fshatit Poliçkë. Ujërat e zeza në këtë fshat derdhen në ambient të hapur, pranë shtëpive dhe më pas në lum.
- Të investohet në infrastrukturën rugore: Të asfaltohet rruga kryesore, me gjatësi 4.5 km. Rruga është në gjendje shumë të keqe dhe deri sa të asfaltohet kjo rrugë banorët kërkojnë që të paktën të mirëmbahet me zhavorr; Të rregullohen rrugët lokale në fshatra.
- Të investohet në zhvillimin e sektorit të pemtarisë, blegtorisë dhe bletarisë.

## **23. KËSHILLI I FSHATRAVE DESIVOJCË**

### **23.1 Pasqyra e përgjithshme**

Këshilli i fshatrave Desivojcë përfshin fshatrat: Desivojcë, Tërstenë, Lajçiq, Vriqevc dhe Sedllar, në të cilat jetojnë 600 banorë. Banorët e këtyre fshatrave ndihen të lënë anash nga institucionet në nivel lokal dhe qendror. Banorët i janë drejtuar disa herë institucioneve, me ç'rast i kanë informuar dhe kanë kërkuar nga ta që të merren masa në drejtim të përmirësimit dhe zgjidhjes së problemeve me të cilat ballafaqohen. Ata kanë kërkuar nga Komuna e Kamenicës dhe Ministria e Infrastrukturës të marrin masa për përmirësimin e infrastrukturës rugore si dhe Ministrinë e Ambientit për dëmet që janë duke u bërë nga separacionet.

Gjithashtu, mosrregullimi i rrugës Shipashnicë e epërme - Desivojcë, sipas banorëve, është bërë edhe shkak i largimit të banorëve nga fshati. Kjo rrugë kishte filluar të rregullohet, mirëpo rreth 7 km ka mbetur pa u asfaltuar. Gjendja më e keqe në këtë rrugë është gjatë reshjeve, kur gropat të cilat ndodhen në rrugë mbushen me ujë. Veç rrugës Shipashnicë e epërme - Desivojcë edhe rrugët lokale në fshatra janë të parregulluara.

Një tjetër problem i ngritur nga banorët është edhe mospërkrahja e banorëve në zhvillimin e blegtorisë, bujqësisë, pemtarisë dhe bletarisë.

## **23.2 Rekomandimet e banorëve:**

- Të asfaltohet rruga Shipashnicë e epërme - Desivojcë, me gjatësi 7 km.
- Të përkrahen banorët në zhvillimin e sektorit të blegtorisë, bujqësisë, pemtarisë dhe bletarisë.
- Të merren masa nga institucionet për ndërprerjen e nxjerrjes së rërës nga lumi në mënyrë ilegale.
- Të hapet zyra e Këshillit lokal në Desivojcë.
- Të sigurohen bursa, për studentë të këtyre fshatrave.

## **24. KËSHILLI I FSHATIT KORETIN**

### **24.1 Pasqyra e përgjithshme**

Ndër problemet kryesore të banorëve të fshatit Koretin është mungesa e rrjetit të kanalizimit dhe mosfunksionimi i rrjetit të ujësjellësit. Mungesa e rrjetit të kanalizimit paraqet rrezik të madh për banorët, pasi ujërat e zeza, jo vetëm të fshatit Koretin, por edhe të qytetit të Kamenicës derdhen në lum. Kurse, rrjeti i ujësjellësit në fshat është vendosur para afro gjashtë vitesh, por ky rrjet ka funksionuar vetëm për disa muaj. Sipas banorëve rreth 90% e ujit që përdorin banorët është i ndotur dhe nuk përdoret për pije.

Infrastruktura rrugore në fshat është e mirë, veç rrugës pranë lumit me gjatësi rreth 800 metra, e cila është e parregulluar. Fshati gjithashtu, ka ndriçim publik.

Fshati ka një shkollë fillore, në të cilën janë bërë disa renovime, si ndërrimi i dritareve dhe lysterja, por që akoma kanë mbetur pa u rregulluar dyshemeja, nxemja, etj.

### **24.2 Rekomandimet e banorëve:**

- Të rregullohet rrjeti i kanalizimit në fshat. Mosrregullimi i këtij rrjeti paraqet rrezik për banorët, pasi ujërat e zeza të fshatit, por edhe të qytetit të Kamenicës derdhen në ambient të hapur dhe më pas në lum. Gjendja akoma më e vështirë është gjatë stinës së verës.
- Të funksionalizohet rrjeti i ujësjellësit. Rreth 90 % e ujit që përdorin banorët është i ndotur.
- Të rregullohet rruga pranë lumit, me gjatësi rreth 800 metra.



*Anëtarët e Komitetit konsultativ për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje në punëtorinë e mbajtur nga ATRC*

## 25. KËSHILLI I FSHATRAVE TOPANICË

### 25.1 Pasqyra e përgjithshme

Këshilli i fshatrave Topanicë përfshin fshatin Topanicë dhe fshatin Bllacë. Problemi kryesor i banorëve është mosfurnizimi i mjaftueshëm me ujë. Banorët e fshatit Topanicë e kanë rregulluar vetë çështjen e sigurimit të ujit, por megjithatë furnizimi me ujë nuk është i mjaftueshëm. Fshatrat gjithashtu, nuk janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit. Banorët e kanë rregulluar pjesërisht çështjen e ujërave të zeza, por ato derdhen në ambient të hapur.

Infrastruktura rrugore në këto fshatra nuk është e mirë. Në fshatin Bllacë jo vetëm rrugët lokale, por edhe rruga kryesore nuk është e asfaltuar. Kurse, në fshatin Topanicë rruga kryesore është asfaltuar, por megjithatë rruga prej xhamisë deri te kodra nuk është e asfaltuar dhe gjithashtu edhe rrugët lokale nuk janë të rregulluara. Asnjë nga fshatrat nuk kanë trotuar, kurse ndriçimi publik është vendosur vetëm në një pjesë të fshatit Topanicë.

Këshilli i fshatrave Topanicë ka një shkollë, të cilën e kanë ndërtuar vetë banorët para vitit 1999. Komuna para disa vitesh ka investuar në rregullimin e nxemjes dhe lyerjen e brendshme të shkollës, megjithatë shkolla akoma nuk i plotëson kushtet për zhvillimin e mësimi. Në këtë shkollë mungon salla e edukatës fizike, shkolla nuk ka fasadë, dritaret janë shumë të vjetra dhe

gjithashtu kulmi i shkollës duhet të ndërrohet, sepse materiali i tij është i dëmshëm dhe paraqet rrezik për nxënësit dhe personelin mësimor.

Këshilli i fshatrave Topanicë ka një ambulantë, por e cila është e vjetër. Komuna para disa vitesh ka bërë rregullimin e vetëm të gjysmës së objektit, kurse gjysma tjetër ka mbetur në gjendje shumë të keqe.

Në fshatin Topanicë është hapsira, e cila më parë është shfrytëzuar si fushë e sportit, por tani është jofunksionale.

## **25.2 Rekomandimet e banorëve:**

- Të sigurohet furnizimi i mjaftueshëm me ujë.
- Të rregullohet trotuari prej rrugës kryesore deri te fshati Domorovc.
- Të investohet në rregullimin e shkollës: të ndërrohen dritaret, të rregullohet një sallë e edukatës fizike, të vendoset fasada, të ndërrohet kulmi, etj.
- Të renovohet edhe pjesa tjetër e objektit të ambulantës.
- Të zgjerohet ura, sepse paraqet probleme në komunikacion.
- Të rregullohet fusha e sportit: të rregullohet rrethoja si dhe hapsira brenda fushës.
- Të vendoset ndriçimi publik në fshatin Bllacë dhe në dy lagje të fshatit Topanicë: Lagjen e Epërme dhe në Qendër.

## **26. KËSHILLI I FSHATRAVE TUGJEC**

### **26.1 Pasqyra e përgjithshme**

Këshilli i fshatrave Tugjec përfshin fshatrat: Tugjec, Sfircë, Zajqevc dhe Gnicë. Veç rrugës kryesore, e cila i lidh fshatrat, asnjë nga rrugët lokale në fshatra nuk është asfaltuar. Banorët ballafaqohen me mungesën e rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit. Në mungesë të rrjetit të ujësjellësit banorët e sigurojnë ujin e pijes në mënyrë individuale. Kurse, në mungesë të rrjetit të kanalizimit ujërat e zeza derdhen në ambient të hapur.

Këshilli i fshatrave Tugjec ka një shkollë fillore në Tugjec, në të cilën vijojnë mësimin mbi 50 nxënës, si dhe dy paralele të ndara në fshatra, në të cilat vijojnë mësimin tre nxënës. Fshatrat kanë një ambulantë në fshatin Tugjec.

## 26.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të vendoset rrjeti i ujësjellësit në fshatra.
- Të vendoset rrjeti i kanalizimit në fshatra.
- Të investohet në rregullimin e infrastrukturës rrugore: Të rregullohen rrugët lokale në fshatra, të cilat janë në gjendje shumë të keqe. Rrugët lokale janë tërësisht të dëmtuara, andaj të shtrohen së paku me zhavor.
- Të mundësohet qasja në rrugën që është e asfaltuar Kamenicë - Kapi.



*Zyrtarët komunal dhe anëtarët e Komitetit konsultativ për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje në punëtorinë e mbajtur nga ATRC*

## 27. KËSHILLI I FSHATIT PETROC

### 27.1 Pasqyra e përgjithshme

Këshilli i fshatit Petroc përfshin vetëm fshatin Petroc. Infrastruktura rrugore në fshatin Petroc është e mirë. Rruga kryesore në fshat është asfaltuar para disa vitesh, por megjithatë disa rrugë lokale nuk janë të rregulluara. Rrjeti i ujësjellësit në fshat është vendosur viteve të fundit por,

për shkak të mungesës së ujit, ky rrjet nuk është funksional. Në fshat gjithashtu, është i vendosur rrjeti i kanalizimit.

Fshati ka një shkollë fillore, e cila është ndërtuar në vitin 2005. Shkolla i plotëson kushtet për zhvillimin e mësimi, veç mungesës së sallës së edukatës fizike. Në fshat është edhe objekti i shkollës së vjetër, i cili mund të renovohet dhe të shfrytëzohet për rregullimin e një salle të edukatës fizike, zyre për Këshillin e fshatit, etj.

Fshati Petroc nuk ka ambulantë. Shërbimet mjekësore banorët i marrin në fshatin Dobërzan që ndodhet 2 km. nga fshati, si dhe në Kamenicë dhe Gjilan.

## **27.2 Rekomandimet e banorëve:**

- Të rregullohet çështja e ujit të pijes.
- Të ndërtohet trotuari prej rrugës kryesore deri te xhamia.
- Të vendosen mbrojtëse në fshat, për shkak të rrëshqitjes së dheut.
- Të largohet objekti i vjetër i shkollës ose të renovohet.
- Të rregullohet ndriçimi publik, i cili është vendosur por nuk është funksional.

## **28. KËSHILLI I FSHATRAVE KOPERNICË**

### **28.1 Pasqyra e përgjithshme**

Këshilli i fshatrave Kopernicë përfshin fshatin Kopernicë dhe Kolloleq. Infrastruktura rrugore në fshatra nuk është e mirë. Rruga kryesore që i lidh dy fshatrat nuk është e rregulluar dhe gjithashtu dy rrugë lokale në fshatin Kopernicë janë të parregulluara. Gjatë këtij viti Komuna ka rregulluar një rrugë në fshatin Kopernicë, megjithatë për banorët është e nevojshme të rregullohet rruga kryesore dhe dy rrugët tjera lokale.

Rrjeti i ujësjellësit është vendosur para dy vitesh në të dy fshatrat, megjithatë ky rrjet nuk është funksional. Rrjeti i ujësjellësit ka qenë funksional në një pjesë, por për shkak të mospagesës së energjisë elektrike ky rrjet është ndërprerë.

Rrjeti i kanalizimit është rregulluar pjesërisht dhe vetëm në një pjesë të fshatit dhe ujërat e zeza derdhen në lum.

Këshilli i fshatrave Kopernicë ka një shkollë fillore, të cilën banorët e kanë ndërtuar me vetëfinancim para vitit 1999. Disa investime janë bërë nga Ministria e arsimit, megjithatë problem për nxënësit paraqet mosfunksionimi i mirë i ngrohjes, pasi radiatorët janë të vegjël dhe me kapacitet të pamjaftueshëm. Këshilli i fshatrave Kopernicë ka një ambulantë.



## 28.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të funksionalizohet rrjeti i ujësjellësit.
- Të bëhet vazhdimi i rrjetit të kanalizimit edhe në pjesën tjetër të fshatit.
- Të investohet në rregullimin e infrastrukturës rrugore: Të rregullohet rruga kryesore, prej shkollës deri te varrezat (të bëhet zgjerimi i rrugës, asfaltimi, rregullimi i trotuarit dhe vendosja e ndriçimit). Kjo rrugë, gjatësia e së cilës është 500 metra, i lidh fshatrat Kopernicë dhe Kolloleq; Të rregullohen edhe dy rrugët lokale.
- Të ndërtohet një park për qytetarët.

## 29. KËSHILLI I FSHATRAVE LISOCKË

### 29.1 Pasqyra e përgjithshme

Këshilli i fshatrave Lisockë përfshin katër fshatra: Lisockë, Zhuj, Saic dhe Gjurišhevc. Ndër problemet kryesore të banorëve të këtyre fshatrave është mosrregullimi i rrugës kryesore prej fshatit Hogosht dhe deri te shkolla e fshatit Lisockë. Komuna para disa vitesh ka rregulluar disa rrugë lokale në fshatra, por një rrugë lokale në fshatin Lisockë nuk është rregulluar.

Fshatrat nuk janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit. Në mungesë të këtij rrjeti, banorët e sigurojnë ujin e pijes në mënyrë individuale kurse, në shkollë nuk ka fare furnizim me ujë. Mungesa e ujit në shkollë është një problem me të cilin banorët ballafaqohen që 12 vite dhe për të cilin në vazhdimësi kanë kërkuar zgjidhje nga institucionet në nivel lokal.

Fshatrat gjithashtu, nuk janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit. Megjithatë, për shkak të terrenit dhe pozitës së këtyre fshatrave është më vështirë të vendoset ky rrjet.

Këshilli i fshatrave Lisockë ka një shkollë fillore në fshatin Lisockë dhe gjithashtu një shkollë në fshatin Gjurišhevc, në të cilin vijojnë mësimin nxënësit deri në klasën e pestë. Shkolla fillore në Lisockë i plotëson kushtet për zhvillimin e mësimin, veç mungesës së furnizimit me ujë. Kurse, shkolla në Gjurišhevc është e vjetër dhe nuk i plotëson kushtet për zhvillimin e mësimin.

Këshilli i fshatrave Lisockë ka një ambulantë, e cila gjithashtu ka mungesë të ujit.

### 29.2 Rekomandimet e banorëve

- Të asfaltohet rruga kryesore, prej fshatit Hogosht dhe deri te shkolla në fshatin Lisockë.
- Të rregullohet çështja e furnizimit të shkollës me ujë.
- Të zgjerohet fusha e sportit, e cila ndodhet afër shkollës.



ATRC falenderon Komunën e Kamenicës, në veçanti Kryetarin dhe Nëkryetarin e Komunës si dhe Kryesuesin e Kuvendit për përkrahjen në implementimin e aktiviteteve në terren. Njëkohësisht, ATRC falenderon anëtarët e Komitetit konsultativ për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, përfaqësuesit e Këshillave Lokale dhe qytetarët, të cilët kontribuan në përpilimin e këtij dokumenti.

#### *Informata shitesë*

- Prioritetet e banorëve të Komunës së Kamenicës, të përmbledhura dhe të publikuara në këtë dokument, janë mbledhur kryesisht gjatë periudhës maj - qershor 2015.
- Pjesa e parë rreth informatave të përgjithshme për komunën është bazuar në web faqen e komunës.

Përkrahur nga:



Implementuar nga:



Advocacy Training and Resource Center

Rr. Gazmend Zajmi, Nr. 20

Prishtinë, Kosovë

Tel/fax: +381 38 244 810

[info@advocacy-center.org](mailto:info@advocacy-center.org)

[www.advocacy-center.org](http://www.advocacy-center.org)

